



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 184.9/16 Prot.

Tiranë, më 20.12 2021

V E N D I M

NR. 60 DT. 20.12 2021

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE PËR 3 (TRE) POZICIONE PUNE SI “PËRGJEGJËS SEKTORI” DHE “SPECIALIST/E” PRANË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 3, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, gërma d); në Rregulloren e UST-së neni 41 “Personeli Administrativ”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në shkresën e Administratorit me nr. 1847, datë 17.12.2021 “Për miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për 3 (tre) pozicione pune si “Përgjegjës Sektori” dhe “Specialist/e” pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse”, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

Të miratojë kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 3 (tre) pozicione pune si “Përgjegjës Sektori” dhe “Specialist/e” pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

I. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për pozicionin e punës si “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes , si më poshtë vijon:

Kriteret e përgjithshme:

- 1) Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
- 2) Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit parë ose të dytë, (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njesimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
- 3) Të ketë përvojë të mëparshme pune;
- 4) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 5) Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- 6) Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

1. Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” ose DIND në shkenca ekonomike/juridike/inxhinierike.
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
3. Të njohë legjislacionin në fuqi.
4. Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

II. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për këto 2 (dy) pozicione pune “Specialist/e” në Sektorin e Prokurimeve dhe Objekteve Sportive pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, janë si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

- 1) Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
- 2) Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit parë ose të dytë, mbështetur në VKM “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura “. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njesimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);
- 3) Të ketë përvojë të mëparshme pune;
- 4) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 5) Ndaj tij të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
- 6) Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- 1) Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor” dhe “Master Profesional” ose DIND në shkenca ekonomike/juridike/inxhinierike.
- 2) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
- 3) Të njohë legjislacionin në fuqi.
- 4) Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
- 5) Të ketë aftësi të mira komunikimi, etike profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

III. Ngarkohet për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al, dhe tek portali i transparencës universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen DOMI

